

VENDIM
Nr. 52, datë 18.10.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	kryesuese;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Genti Ibrahim, i,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 14.9.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 1(M) 2023 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Mitat Dautaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Entela Beci, Emi Dautaj, Arbi Dautaj.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 3717, datë 9.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 3898, datë 2.12.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 21001-01221-00-2015 të regjistrit themeltar, datë 15.9.2022 dhe nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 35, pika 4, 42, 53, pika 3, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 49, 50 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Entela Beci, Emi Dautaj dhe Arbi Dautaj, që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Mitat Dautaj dhe subjekti i interesuar, Entela Beci, kanë qenë bashkëshortë dhe janë prindër të subjekteve të interesuara Emi Dautaj dhe Arbi Dautaj. Për shkak të mosmarrëveshjeve mes bashkëshortëve, në datën 30.1.2013, subjekti i interesuar Entela Beci (në atë kohë me mbiemër Dautaj) ka paraqitur padi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përmes së cilës ka kërkuar zgjidhjen e martesës mes saj dhe kërkesit, si dhe caktimin tek ajo për rritjen dhe edukimin të djalit të tyre (në atë kohë në moshë të mitur), subjektit të interesuar Arbi Dautaj, duke i ngarkuar kërkesit pagesën për detyrimin për ushqim. Në atë proces ka shprehur interes për të marrë pjesë si ndërhyrëse kryesore edhe e bija, subjekti i interesuar Emi Dautaj (në atë kohë në moshë madhore dhe studente në një universitet të huaj), e cila në datën 4.4.2013, ka paraqitur në seancën gjyqësore kërkesën e saj, duke u bazuar në nenet 189 dhe 190 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*).

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3717, datë 9.4.2013, ka vendosur pranimin e padisë, duke zgjidhur martesën mes kërkuarit dhe subjektit të interesuar Entela Beci. Për sa u përket pasojave nga zgjidhja e martesës, gjykata e shkallës së parë ka vendosur që subjekti i interesuar Arbi Dautaj të qëndrojë pranë nënës së tij, duke detyruar kërkuarin që të paguajë shumën 20.000 lekë në muaj, si kontribut financiar për rritjen dhe edukimin e tij. Po kështu, në atë vendim, gjykata e shkallës së parë ka disponuar ndarjen mes ish-bashkëshortëve të shpenzimeve për edukimin e subjektit të interesuar Emi Dautaj, e cila në atë kohë ishte nën moshën 25 vjeç dhe ndiqte studimet universitare, duke caktuar në ngarkim të kërkuarit detyrimin për të paguar shumën 70.000 lekë në muaj. Për sa i përket detyrimit për pagimin e shumave në fjalë, gjykata e shkallës së parë ka disponuar që ato të fillojnë që nga data e paraqitjes së padisë në atë gjykatë.

3. Kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, në datën 12.4.2013, kërkuari ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, duke kundërshtuar atë pjesë të atij vendimi që ka disponuar për detyrimin e tij për të përballuar financiarisht shpenzimet për edukimin e së bijës në shumën 70.000 lekë në muaj, e llogaritur që nga data e paraqitjes së padisë, të cilën e ka vlerësuar si shkelje të rëndë të ligjit procedural dhe material, me pretendimin se, ndonëse ai në mënyrë vullnetare e kishte mbështetur financiarisht të bijën për vitin shkollor 2012–2013, fakt i deklaruar edhe nga palët në seancë gjyqësore, disponimi në vendimin e gjykatës për caktimin si detyrim të pagesës së shumës në fjalë, pa u parashtruar si kërkim në objektin e padisë dhe pa e legjitimuar vetë përfituesen e asaj shume për të marrë pjesë në atë proces, si dhe, për më tepër, dhënia e vendimit me ekzekutim të përkohshëm, është i padrejtë dhe i ka shkaktuar pasoja financiare të rënda.

4. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 3898, datë 2.12.2014, ka vendosur: “*Lënien në fuqi të vendimit nr. 3717, datë 9.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*”. Ajo gjykatë ka arsyetuar njëloj sikundër gjykata e shkallës së parë.

5. Kundër vendimit të gjykatës së apelit, në datën 31.12.2014, kërkuari ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, mbi bazën e të cilit ka regjistruar çështjen me nr. 21001-01221-00-2015, datë 8.5.2015. Në rekurs, kërkuari ka kërkuar prishjen e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit, duke parashtruar se gjykatat e faktit kanë shkelur rëndë procedurën për sa i përket disponimit në vendimet e tyre tej kërtimeve të padisë, formimit të ndërgjygjësisë, përcaktimit të detyrimit monetar në mënyrë arbitrare dhe dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm për atë detyrim, pa vlerësuar pagesat e kryera prej tij deri në datën e shpalljes së vendimit të gjykatës, nga të cilat i janë shkaktuar pasoja të rënda, pasi është detyruar që të paguajë dy herë për të njëjtin detyrim.

6. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 19.5.2016, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore. Gjatë kohës së qëndrimit të çështjes në pritje për t’u shqyrtuar në Gjykatën e Lartë, kërkuari ka paraqitur disa kërkesa për shqyrtimin e rekursit të tij me procedurë të përshpejtuar, konkretisht në datat 6.7.2015, 27.5.2016, 14.11.2016, 30.1.2017, 26.4.2017, 10.11.2017, 14.11.2017, nëpërmjet të cilave ka pretenduar se çështja e tij ka të bëjë me pasojat e zgjidhjes së martesës dhe për këtë shkak hyn në rrethin e çështjeve civile që Gjykata e Lartë shqyrton me procedurë të përshpejtuar.

7. Në datën 21.2.2018 kërkuari ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesën e regjistruar me nr. 763 prot., datë 21.2.2018, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Kolegji Civil i asaj gjykate. Në atë kërkesë ai ka pretenduar se, ndonëse ajo gjykatë kishte pasur numrin e plotë të gjyqtarëve, nuk e ka shqyrtuar rekursin edhe pas kalimit të afatit të ri të shtuar përmes ndryshimeve të KPC-së në vitin 2017, duke mos vlerësuar asnjë nga kërkesat e shumta të tij për gjykimin e çështjes me procedurë të përshpejtuar, të cilat lidheshin me pasojat që kishte shkaktuar mënyra e zgjidhjes së mosmarrëveshjes nga gjykatat e ulëta, të shprehura edhe në rekurs.

8. Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 4, datë 22.5.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, duke arsyetuar se, ndonëse Kolegji Civil i asaj gjykate ka marrë masa për shqyrtimin e çështjes, për shkaqe objektive të lidhura me ngarkesën dhe numrin e madh të çështjeve që janë regjistruar në Gjykatën e Lartë dhe janë në pritje për t'u shqyrtuar, si dhe me numrin e kufizuar të gjyqtarëve, përfundimi i saj ka qenë i pamundur.

9. Në vijim, kërkuesi, në datën 24.11.2020, ka paraqitur sërish në Gjykatën e Lartë kërkesën për gjykimin e çështjes së tij me procedurë të përshpejtuar, kërkesë të cilën gjyqtari relator e ka pranuar, duke caktuar shqyrtimin e çështjes brenda kohës së mbetur në gjashtëmujorin e parë të vitit 2022.

10. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 21001-01221-00-2015 të regjistrimit themeltar, datë 15.9.2022, ka vendosur revokimin e vendimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe kthimin e saj për shqyrtim në dhomën e këshillimit, mbi bazë të dokumenteve, për të cilin ka njoftuar palët me shkresën nr. 21001-01221-00-2015 prot., datë 19.9.2022. Po në të njëjtën shkresë, palët janë bërë me dije se çështja e tyre do të shqyrtohej në datën 6.10.2022, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime me shkrim jo më vonë se 5 ditë përpara datës së caktuar për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit. Në datën 23.9.2022, kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë parashtresë me shkrim, duke kërkuar revokimin e vendimit të ndërmjetëm të datës 15.9.2022, me qëllim që çështja të shqyrtohej në seancën gjyqësore me praninë e palëve, si dhe ndryshimin e vendimit të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë, sikundër ka parashtruar edhe në rekursin e tij të paraqitur në datën 31.12.2014.

11. Për sa i përket themelit të çështjes, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, në dhomën e këshillimit, ka vendosur: "Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur Mitat Dautaj, kundër vendimit nr. 3898, datë 2.12.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë.". Në atë vendim, për sa i përket kërkesës për revokimin e vendimit të datës 15.9.2022, Gjykata e Lartë ka arsyetuar se rekursin mund ta shqyrtonte në dhomën e këshillimit. Për sa i përket rekursit të kërkuesit, ajo gjykatë ka konkluduar se nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së (*shih paragrafët 19 dhe 25, të vendimit nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Gjykatës së Lartë*).

12. Me kërkesën e datës 19.1.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për shfuqizimin e vendimeve nr. 3898, datë 2.12.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, nr. 21001-01221-00-2015, të regjistrimit themeltar, datë 15.9.2022 dhe nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.

13. Kolegji i Gjykatës, në datën 4.4.2023, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, në datën 19.4.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, për të cilën palët janë njoftuar rregullisht.

14. Me vendimet nr. 10, datë 5.4.2023 dhe nr. 11, datë 6.4.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur pranimin e kërkesave për heqjen dorë nga marrja pjesë në shqyrtimin e kësaj çështjeje të paraqitura nga Kryetarja e Gjykatës dhe nga një anëtar tjetër i saj.

15. Në vijim, në datën 19.4.2023, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

16. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se vendimet e Gjykatës së Lartë i kanë cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, në drejtim të:

A. Për vendimin nr. 21001-01221-00-2015 të regjistrit themeltar, datë 15.9.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

16.1. *Së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë, përmes shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar, si dhe për të marrë pjesë në mënyrë aktive në proces, në kuptimin e pranisë së tij fizike në seancë gjyqësore. Ajo gjykatë nuk ka kompetencë për të revokuar vendimin e datës 19.5.2016, të kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore dhe, për më tepër, nuk mund të vendoste për mënyrën e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit pa praninë e palëve, pasi ato janë thirrur një herë për të qenë të pranishme në seancën e datës 5.7.2018. Mungesa fizike dhe mospjesëmarrja aktive në proces për t'u dëgjuar për shkaqet e rekursit, kanë ndikuar në vendimin përfundimtar të themelit të çështjes në drejtim të mospranimi të rekursit.

B. Për vendimin nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

16.2. *Së drejtës së aksesit në gjykatë*, pasi Gjykata e Lartë, përkundër parimit të disponibilitetit të padisë, ka legjitimuar paditësen në atë proces për pretendime të pakërkuara në objektin e saj, konkretisht për sa i përket detyrimit për të paguar për shpenzimet e shkollimit jashtë shtetit të së bijës, për të cilat mund të ishte legjitimuar vetëm kjo e fundit, për shkak se ka qenë në moshë madhore, për rrjedhojë interesat e saj nuk mund të përfaqësoheshin nga një person tjetër pa një akt përfaqësimi për këtë qëllim.

16.3. *Së drejtës për një gjykatë të paanshme*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka vlerësuar rrethanat e konfliktit të interesit të gjyqtarës relatore në gjykatën e apelit, si dhe as faktin e caktimit pa short të çështjes tek ajo, duke mos e garantuar këtë të drejtë. Kërkuesi ka paraqitur kërkesat për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues të gjykatës së apelit, të cilat, ndonëse përmbanin shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 72 të KPC-së, nuk janë pranuar.

16.4. *Parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka vlerësuar faktin se gjykata e apelit i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të dhënë shpjegime për shkaqet e ankimit, përmes zhvillimit të seancës gjyqësore të datës 2.12.2014 në mungesë të tij, pa marrë parasysh kërkesën për shtyrjen e saj, pasi ndodhej në një tjetër gjykim po në atë gjykatë.

16.5. *Së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm*, pasi Gjykata e Lartë, ndonëse ka pasur në dispozicion numrin e plotë të gjyqtarëve për çështjen civile të regjistruar në datën 8.5.2015, ka disponuar me vendim në datën 6.10.2022, duke tejkaluar edhe afatin ligjor të zgjatur pas ndryshimeve të KPC-së, ku për atë çështje ka pasur disa kërkesa për gjykimin me procedurë të përshpejtuar. Po kështu, i gabuar është edhe vendimi i asaj gjykate nr. 4, datë 22.5.2018, përmes të cilit ka rrëzuar kërkesën e datës 21.2.2018, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Kolegji Civil i asaj gjykate, sipas kriterëve të parashikuara në nenet 399/1 – 399/12 të KPC-së. Mosshqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm ka sjellë pasoja ekonomike në dëm të tij.

16.6. *Standardit të arsyetimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar për shkaqet me natyrë kushtetuese të rekursit dhe për argumentet e tjera të së njëjtës natyrë në parashtrimin me shkrim të paraqitur në datën 23.9.2022, përpara shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Ato kanë të bëjnë me evidentimin e të gjitha shkeljeve të të drejtave kushtetuese përgjatë gjykimit të çështjes në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, në mënyrë të veçantë në drejtim të kuptimit të përgjegjësisë prindërore dhe kufijve të ushtrimit të saj, sikurse edhe në drejtim të parimit të paanshmërisë në gjykimin e çështjes në shkallën e dytë të gjyqësorit. Po kështu, ajo gjykatë nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar as për shkeljen e së drejtës kushtetuese të evidentuar në

vendimin e saj përfundimtar të datës 6.10.2022, lidhur me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit.

16.7. *Së drejtës për të pasur një zgjidhje martese sipas ligjit*, pasi kjo e drejtë është mohuar nga gjykimi i çështjes në të tria shkallët e gjyqësorit me shkelje të parimeve themelore të procedurës së gjykimit, të parashikuara në KPC, me shkelje të të drejtave materiale, të parashikuara shprehimisht në Kodin e Familjes dhe në Kushtetutë. Gjykata e Lartë dhe gjykatat e faktit i kanë cenuar të drejtat ekonomike dhe të personalitetit, pasi e kanë vendosur në pozitën e debitorit që duhet të paguajë dy herë për të njëjtin detyrim dhe nisur nga kjo situatë, është detyruar që të nisë disa procese të tjera gjyqësore për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore.

16.8. *Së drejtës për ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota, ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin*, pasi Gjykata e Lartë nuk e ka vlerësuar pretendimin e parashtruar në rekurs se vendimet e gjykatave të faktit përmbajnë fakte të pavërteta, konkretisht atë se kërkuesi ka qenë dakord që i biri, subjekti i interesuar Arbi Dautaj, të mos paraqitej në gjykatë për t'u pyetur në lidhje me qëndrimin e tij te njëri nga prindërit pas zgjidhjes së martesës mes tyre, se ai ka të ardhura të tjera të përhershme nga profesioni si avokat dhe nga qiratë e pasurive të paluajtshme në pronësi të tij, si dhe të faktit se gjykata në çështjen e tij duhet të vendosë për mirërritjen dhe edukimin e tre të miturve (kur në të vërtetë vetëm subjekti i interesuar Arbi Dautaj ishte i mitur).

17. ***Subjektet e interesuara, Entela Beci, Emi Dautaj dhe Arbi Dautaj***, kanë paraqitur të njëjtat argumente dhe, në mënyrë të përmblodhur, kanë prapësuar si vijon:

A. Për pretendimin ndaj vendimit nr. 21001-01221-00-2015 të regjistrit themeltar, datë 15.9.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

17.1. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe të gjykatës së caktuar me ligj*, kërkuesi nuk legjitimohet, pasi vendimi nr. 21001-01221-00-2015 i regjistrit themeltar, datë 15.9.2022, është i ndërmjetëm, nuk ka disponuar për pretendime të parashtruara nga kërkuesi, si dhe nuk ka zgjidhur thelbin e mosmarrëveshjes, prandaj ai nuk mund të përfshihet në juridiksionin kushtetues. Për më tepër, ky pretendim është edhe i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë, pas ndryshimeve të KPC-së në vitin 2021, përmes ligjit nr. 44/2021, datë 23.3.2021, si rregull i shqyrton çështjet në dhomën e këshillimit, për rrjedhojë ajo gjykatë ka vepruar në përputhje me kompetencat e njohura me ligj. Po kështu, përmes njoftimit të datës 19.9.2022 kërkuesi i është dhënë mundësia që të paraqesë pretendime me shkrim në mbështetje të shkaqeve të rekursit të tij, mundësi të cilën e ka shfrytëzuar përmes parashtresës me shkrim të datës 23.9.2022, ku ka shprehur të njëjtat si në rekursin e tij të datës 31.12.2014, duke i garantuar të drejtën për t'u dëgjuar.

B. Për pretendimet ndaj vendimit nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë

17.2. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit në gjykatë*, kërkuesi nuk legjitimohet, pasi pretendimin për shpenzimet e shkollimit jashtë shtetit të së bijës, subjekti i interesuar, Entela Beci, e ka parashtruar në padi dhe palët e kanë diskutuar dhe trajtuar përgjatë gjithë procesit, për rrjedhojë gjykatat janë shprehur me vendim për të. Kërkuesi nuk ka shfrytëzuar ndonjë mjet procedural gjatë gjykimit për ta përjashtuar atë pretendim nga vlerësimi përfundimtar i gjykatës, ndërsa argumentet në mbështetje të pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë i ka paraqitur drejtpërdrejt në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ai nuk legjitimohet, pasi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Për më tepër, ky pretendim është edhe i pabazuar, pasi përmes deklaratës notoriale nr. 9584 rep., datë 11.6.2012, ka deklaruar se merr përsipër pagesën për shpenzimet e shkollimit të së bijës në universitetin jashtë shtetit. Gjithashtu, edhe gjykata e shkallës së parë nuk e ka pranuar kërkesën e saj për ndërhyrje kryesore, me arsyetimin se caktimi i detyrimit për ushqim për fëmijët, ku përfshihen edhe ata në moshë madhore që vijnë studimet në arsimin e

lartë, sipas nenit 197, paragrafi i tretë, të Kodit të Familjes, përbën një nga pasojat e zgjidhjes së martesës, për të cilën vetë gjykata është e detyruar që të shprehet në lidhje me të.

17.3. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për një gjykatë të paanshme* është i pabazuar dhe duhet të rrëzohet, pasi kërkuesi nuk ka mbështetur me asnjë provë kërkesën për përjashtimin e gjyqtarese relatore në gjykatën e apelit, në kuptim të nenit 72 të KPC-së. Po kështu, edhe pretendimi se çështja ishte caktuar tek ajo gjyqtare pa short është i pabazuar, pasi ajo ishte anëtarja e mbetur e trupit gjykues që do të shqyrtonte çështjen, për shkak se gjyqtari relator (të cilit çështja iu caktua me short) dhe një anëtar tjetër i atij trupi gjykues kanë paraqitur dorëheqjet respektive, të cilat u miratuan nga kryetari i gjykatës së apelit. Për rrjedhojë, çështja kaloi automatikisht te gjyqtarja në fjalë, tashmë si relatore, ndërsa trupi gjykues u plotësua me dy gjyqtarë të tjerë, në zbatim të nenit 9, të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 238/1a, datë 24.12.2008, “Për procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore”, të ndryshuar. Kërkuesi nuk ka parashtruar asnjë argument se si kjo procedurë ka cenuar paanshmërinë e gjykatës.

17.4. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit*, kërkuesi nuk legjitimohet, pasi në procesin e gjykimit të çështjes në shkallën e parë të gjyqësorit ai ka paraqitur të gjitha provat që ka çmuar se provojnë pretendimet e tij, ndërsa në ankimin drejtuar gjykatës së apelit ka parashtruar kundërshtimet e tij ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë në çdo aspekt, bazuar në aktet e ndodhura në dosje, duke mos shprehur ndonjë pretendim ose kërkesë për paraqitjen e ndonjë prove të re. Argumentin se gjykata e apelit i ka mohuar të drejtën për t’u dëgjuar dhe për të dhënë shpjegime për shkaqet e ankimit, për shkak se e ka zhvilluar seancën gjyqësore në mungesë të tij, e ka paraqitur drejtpërdrejt në këtë Gjykatë, për rrjedhojë ai nuk legjitimohet, pasi nuk ka shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Gjithashtu, ky pretendim është i pabazuar, pasi kërkuesi ka pasur dijeni për datën dhe orën e seancës gjyqësore në gjykatën e apelit, por ka kërkuar shtyrjen e saj, me arsyetimin se në atë moment ndodhej në një tjetër proces po në atë gjykatë si avokat, duke zgjedhur që të marrë pjesë në këtë të dytën dhe të mos jetë i pranishëm në çështjen e tij. Ndërkohë, në gjykatën e shkallës së parë kërkuesi kishte caktuar avokate për mbrojtjen e tij në atë proces edhe në mungesë, të cilën nuk e zëvendësoi. Po kështu, ndonëse gjykimi u zhvillua pa praninë e tij, kërkuesi ka marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e ngritura në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

17.5. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, kërkuesi nuk legjitimohet, pasi, ndonëse ka paraqitur disa kërkesa për shqyrtimin e çështjes me procedurë të përsheptuar, nuk ka ndjekur hapat proceduralë të parashikuara në nenet 399/1 e vijues të KPC-së, për rrjedhojë nuk ka shteruar mjetet juridike efektive. Për më tepër, në kushtet kur themeli i mosmarrëveshjes është zgjidhur me vendim përfundimtar, ai nuk mund të realizojë rivendosjen e kësaj të drejte përmes gjykimit kushtetues.

17.6. Pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit vendimit* është i pabazuar dhe duhet të rrëzohet, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë përgjigje të arsyetuar, si për sa i përket vendimit të ndërmjetëm të datës 15.9.2022, përmes të cilit vendosi që çështjen ta shqyrtojë në dhomën e këshillimit, për rrjedhojë edhe të pretendimit të kërkuesit për revokimin e tij të shprehur në parashtresën e datës 23.9.2022, ashtu edhe për sa i përket disponimit nga gjykatat e faktit për detyrimin e tij për të paguar për një pjesë të shpenzimeve për shkollimin e së bijës. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkuesit në rekurs dhe në parashtresën me shkrim kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të vlerësimit të provave nga gjykatat e faktit dhe nuk janë të natyrës kushtetuese, për të cilat Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kanë respektuar normat procedurale të gjykimit, duke zhvilluar një proces të rregullt ligjor.

17.7. Pretendimi për cenimin e së drejtës për të pasur një zgjidhje martesë sipas ligjit është i pabazuar dhe duhet të rrëzohet, pasi kërkuksi ka shprehur qartë qëndrimin e tij se është dakord për zgjidhjen e martesës dhe gjykatat e kanë zgjidhur atë martesë.

17.8. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota, ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin, kërkuksi nuk legjitimohet, pasi nuk ka shfrytëzuar mjetin procedural të parashikuar në nenin 312 të KPC-së për ndreqjen e gabimeve në vendimin e gjykatës, për rrjedhojë ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuksit

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

19. Në rastin konkret, Gjykata vëren se ankimi kushtetues individual ka në objekt tre kërtime të cilat lidhen: i. me procedurën e zhvilluar në Gjykatën e Lartë, konkretisht pretendimet ndaj vendimit të datës 15.9.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë lidhur me shqyrtimin e çështjes në atë gjykatë në dhomën e këshillimit dhe jo në seancë gjyqësore; ii. respektimin e afatit për shqyrtimin e çështjes në atë gjykatë pas vendimit të saj nr. 4, datë 22.5.2018; iii. mënyrën e zgjidhjes së themelit të mosmarrëveshjes për pretendimet ndaj procesit që ka përfunduar me vendimin e datës 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

20. Gjykata çmon se kërkuksi legjitimohet *ratione personae*, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ku janë dhënë vendimet e kundërshtuara, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

21. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuksi nuk legjitimohet për pretendimet ndaj vendimit përfundimtar të Gjykatës së Lartë, konkretisht ato për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe së të drejtës për ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta, të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin, me argumentin se këto pretendime janë ngritur drejtpërdrejtë në këtë Gjykatë, pa shfrytëzuar ai gjatë gjykimit mjetet procedurale për mbrojtjen e tyre, për rrjedhojë nuk ka shteruar mjetet juridike efektive.

23. Për sa i përket pretendimit të kërkuksit për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, Gjykata vëren se kërkuksi është mbështetur në argumentin se Gjykata e Lartë nuk e ka vlerësuar faktin që gjykata e apelit e ka zhvilluar seancën gjyqësore të datës 2.12.2014, në

mungesë të tij, pa marrë parasysh kërkesën për shtyrjen e seancës, kur në të njëjtën kohë ai ndodhej në një tjetër gjykim po në atë gjykatë, duke mos i dhënë mundësinë për shpjeguar shkaqet e ankimit. Por, në rekursin e tij kërkuesi nuk rezultoi të ketë shprehur pretendime për sa i përket cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor për shkak të zhvillimit të seancës gjyqësore në gjykatën e apelit në mungesë të tij, për rrjedhojë ai nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës për këtë pretendim, pasi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

24. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për ndreqjen apo fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota, ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin, kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë nuk e ka vlerësuar pretendimin e parashtruar prej tij në rekurs se vendimet e gjykatave më të ulëta përmbajnë fakte të pavërteta, konkretisht se ai ka qenë dakord që i biri, subjekti i interesuar Arbi Dautaj, të mos paraqitej në gjykatë për t'u pyetur në lidhje me qëndrimin e tij te njëri nga prindërit pas zgjidhjes së martesës, se kërkuesi ka të ardhura të tjera të përhershme nga profesioni si avokat dhe nga qiratë e pasurive të paluajtshme në pronësi të tij, si dhe të faktit se gjykata në çështjen e tij duhet të vendosë për mirërritjen dhe edukimin e tre të miturve (kur në të vërtetë vetëm i biri ishte i mitur dhe nga martesa kanë pasur vetëm dy fëmijë). Për këto pretendime Gjykata eidenton se në kuptim të neneve 312 dhe 313 të KPC-së, pas shpalljes së vendimit, ndreqja e gabimeve në shkrim ose në llogari, pasaktësitë e dukshme dhe mosshprehja nga gjykata për të gjitha kërkesat për të cilat pala ka paraqitur prova, bëhet nga gjykatat e zakonshme, sipas kompetencës që parashikon KPC-ja. Po kështu, sipas nenit 314 të KPC-së, ato gjykata kanë të drejtë edhe të japin sqarime ose të bëjnë interpretimin e vendimit që kanë dhënë kur është i errët dhe e kërkojnë palët, gjersa ai vendim nuk është ekzekutuar. Për sa kohë që kërkuesi nuk i ka shfrytëzuar këto mjete juridike që ofron legjislacioni, ai nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës as në lidhje me këtë pretendim.

25. Në analizë të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, Gjykata konstaton se për sa i përket kërimit të parë të ankimit kushtetues individual, për cenimin e së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe së drejtës për t'u gjykuara nga një gjykatë e caktuar me ligj, të lidhura me vendimin nr. 21001-01221-00-2015 të regjistrimit themeltar, datë 15.9.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kërkuesi, në parashitresën me shkrim të datës 23.9.2022, ka kërkuar revokimin e atij vendimi, duke i kërkuar Gjykatës së Lartë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për këtë kërkesë ajo gjykatë është shprehur në vendimin përfundimtar të datës 6.10.2022, për rrjedhojë kërkuesi e ka plotësuar këtë kriter, pasi nuk ka më mjete juridike të tjera në dispozicion¹.

26. Gjykata, për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, në referim të akteve të ndodhura në dosjen gjyqësore, konstaton se kërkuesi e ka mbështetur këtë pretendim me argumentin se vendimet e gjykatave të faktit dhe vendimi i Gjykatës së Lartë janë të pabazuara në ligj për sa i përket caktimit në procesin e zgjidhjes së martesës të detyrimit për të paguar shpenzimet e shkollimit të së bijës, e cila nuk ia kishte kaluar tagrat nënës së saj për ta përfaqësuar dhe mbrojtur në atë proces. Për shkak se ishte në moshë madhore, ajo kishte të drejtë t'i kërkonte vetë shumat për ato shpenzime, si në kuptimin substancial, ashtu edhe procedural. Këtë qëndrim kërkuesi e ka shprehur në të gjitha shkallët e gjykimit të çështjes, për rrjedhojë Gjykata çmon se kërkuesi plotëson kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive për këtë pretendim.

¹ Në lidhje me pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe gjykatës së caktuar me ligj, të lidhura me vendimin nr. 21001-01221-00-2015 të regjistrimit themeltar, datë 15.9.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, gjyqtarja Elsa Toska mbajti të njëjtin qëndrim siç e ka mbajtur edhe në çështje të tjera, se çdo pretendim i lidhur me vendimin e ndërmjetëm në vështrim të së drejtës për akses dhe së drejtës për kontradiktoritet, për sa kohë që vendimi i ndërmjetëm për përcaktimin e mënyrës së shqyrtimit të një çështjeje në kolegjet e Gjykatës së Lartë u është njoftuar palëve, është haptazi i pabazuar, pavarësisht nëse ata kanë paraqitur argumente mbi të ose jo.

27. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vëren se kërkuesi ka argumentuar se Gjykata e Lartë për çështjen civile të regjistruar në datën 8.5.2015 ka disponuar me vendim në datën 6.10.2022, duke tejkaluar edhe afatin ligjor të zgjatur pas ndryshimeve të KPC-së, megjithëse për atë çështje ka pasur disa kërkesa për gjykim me procedurë të përshpejtuar. Po kështu, sipas tij, i gabuar është edhe vendimi i asaj gjykate nr. 4, datë 22.5.2018, përmes të cilit ka rrëzuar kërkesën e datës 21.2.2018, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit nga Kolegji Civil i asaj gjykate, sipas kriterëve të parashikuara në nenet 399/1–399/12 të KPC-së.

28. Gjykata konstaton se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, për shkak të gjykimit të rekursit përtej afatit të arsyeshëm, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, është parashtruar nga kërkuesi fillimisht në Gjykatën e Lartë përmes kërkesës së tij të datës 21.2.2018, për të cilën Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 4, datë 22.5.2018, ka vendosur rrëzimin e saj. Ndonëse kërkuesi, në datën 24.11.2020, ka paraqitur kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, për të cilën gjyqtari relator ka shprehur miratimin e tij, duke caktuar që çështja të shqyrtohej brenda 6-mujorit të parë të vitit 2022, Gjykata e Lartë ka disponuar me vendim përfundimtar në datën 6.10.2022.

29. Gjykata, për sa i përket kriterit të shterimit të mjeteve juridike, ka theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjykata vëren se kërkuesi ka ngritur pretendimin për mosgjykimin brenda një afati të arsyeshëm të çështjes së themelit nga Gjykata e Lartë, pasi Kolegji Civil i asaj gjykate kishte disponuar me vendimin e datës 22.5.2018, për rrëzimin e kërkesës së paraqitur në datën 21.2.2018, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Gjykata e Lartë ka argumentuar se nuk mund ta shqyrtojë çështjen e kërkuetit për shkaqe objektive që lidhen me ngarkesën e madhe të çështjeve dhe numrin e kufizuar të gjyqtarëve. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkesa për përshpejtimin e procedurave në rastin e kërkuetit e ka humbur qëllimin e saj - përshpejtimin e procedurave ose parandalimin e tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë. Pra, mjeti juridik “kërkesa për përshpejtimin e procedurave”, që kërkuesi ka pasur në dispozicion sipas dispozitave të KPC-së, në rastin e tij nuk ka qenë *efektiv*, në kuptimin që nuk ka qenë real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë. Në këtë kuptim, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuetit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual, për rrjedhojë në çështjen konkrete përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike.

31. Gjykata vlerëson, gjithashtu, se kërkuesi legjitimohet në lidhje me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive edhe për sa u përket pretendimeve të tjera për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për një gjykatë të paanshme dhe të standardit të arsyetimit të vendimit, pasi argumentet për këto pretendime lidhen me vendimmarrjen e Gjykatës së Lartë, për të cilat ai nuk ka më mjete të tjera juridike në dispozicion.

32. Për sa i përket legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Gjykata vëren se procesi gjyqësor në Gjykatën e Lartë ka përfunduar me vendimin e datës 6.10.2022, ndërsa ankimi kushtetues individual për pretendimet ndaj këtij vendimi është paraqitur në datën 19.1.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor, për rrjedhojë ai legjitimohet *ratione temporis*.

33. Për sa i përket pretendimit për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar asaj me ankim kushtetues individual në rrethanat kur ka paraqitur më parë kërkesë në Gjykatën e Lartë, në zbatim të nenit 399/6 të KPC-së, për konstatimin e shkeljes

së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes së tij, për të cilën Kolegji Civil, me vendimin nr. 4, datë 22.5.2018, ka vendosur rrëzimin. Në kushtet kur çështja e tij ka mbetur e pashqyrtuar deri në datën 6.10.2022, në të cilën Gjykata e Lartë ka disponuar me vendim përfundimtar, Gjykata konstaton se shkelja ka qenë vazhduese deri në atë datë, për rrjedhojë çmon se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis* në lidhje me këtë pretendim.

34. Në lidhje me legjitimimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se subjektet e interesuara kanë prapësuar se kërkuesi nuk legjitimohet për pretendimet ndaj vendimit të datës 15.9.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit, pasi është vendim i ndërmjetëm, përmes të cilit nuk është disponuar për pretendime që kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe nuk është zgjidhur thelbi i mosmarrëveshjes, për rrjedhojë pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe të gjykit nga një gjykatë e caktuar me ligj nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues. Sipas subjekteve të interesuara, kërkuesi nuk legjitimohet edhe për pretendimin për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, pasi në kushtet kur themeli i mosmarrëveshjes është zgjidhur me vendim përfundimtar, ai nuk mund të realizojë rivendosjen e kësaj të drejte përmes gjykit kushtetues. Po kështu, sipas tyre, kërkuesi nuk legjitimohet as për pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë përgjigje të arsyetuar si për sa i përket kërkesës për revokimin e vendimit të ndërmjetëm të datës 15.9.2022, ashtu edhe për sa u përket pretendimeve për mënyrën e zgjidhjes së thelbit të mosmarrëveshjes nga gjykatat e faktit. Pretendimet dhe argumentet e parashtruara në rekursin e kërkuetit, si dhe në parashtrësën me shkrim të datës 23.9.2022 kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të ligjit dhe të vlerësimit të provave nga gjykatat e faktit dhe nuk janë të natyrës kushtetuese. Gjithashtu, kërkuesi nuk legjitimohet as për pretendimin për cenimin e së drejtës për të pasur një zgjidhje martese sipas ligjit, pasi ai e ka shprehur qartë qëndrimin e tij për zgjidhjen e martesës dhe, po kështu, gjykatat kanë disponuar në këtë drejtim duke e zgjidhur martesën.

35. Për sa i përket vlerësimit të këtij kriteri për pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe të gjykatës së caktuar me ligj, referuar vendimit të datës 15.9.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si dhe për pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit në gjykatë, së drejtës për një gjykatë të paanshme dhe së drejtës për të pasur një zgjidhje martese sipas ligjit, të ngritura ndaj vendimit nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

36. Sipas njërit qëndrim², kërkuesi nuk legjitimohet *ratione materiae* për pretendimin ndaj vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 15.9.2022 për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektin e së drejtës së aksesit për t'u dëgjuar dhe të gjykatës së caktuar me ligj, si dhe për pretendimet ndaj vendimit përfundimtar të asaj gjykate të datës 6.10.2022 për cenimin e së drejtës së drejtës së aksesit në gjykatë dhe së drejtës për të pasur një zgjidhje martese sipas ligjit. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja "P", të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, kontrolli kushtetues ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara në Kushtetutë, kur pasojat negative janë të drejtpërdrejta dhe reale për kërkuetin dhe kur shqyrtimi kushtetues i çështjes mund të rivendosë të drejtën kushtetuese të shkelur. Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm, por Gjykata mund t'i marrë në konsideratë vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore, duke bërë

² Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Elsa Toska, Sonila Bejtja dhe Genti Ibrahim.

vlerësim të natyrës kushtetuese të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 7, datë 7.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim, nisur nga argumentet e kërkuarit, këto pretendime në thelb kanë të bëjnë me mënyrën se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë zbatuar ligjin dhe se si kanë vlerësuar provat, për rrjedhojë nuk hyjnë në kompetencën e kësaj Gjykate. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për një gjykatë të paanshme, kërkuari nuk ka paraqitur argumente në nivel kushtetues lidhur me elementin *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Gjithashtu, ai nuk ka argumentuar se si ka ndikuar vendimmarrja e trupit gjykues të gjykatës së apelit në gjykimin e çështjes nga Gjykata e Lartë, prandaj, sipas këtij qëndrimi, kërkuari nuk e ka ngritur këtë pretendim në nivel kushtetues, për rrjedhojë nuk legjitimohet *ratione materiae* as për këtë pretendim.

37. Sipas qëndrimit tjetër³, pretendimet e kërkuarit për cenimin e të drejtave të aksesit, për t'u dëgjuar, të gjykatës së caktuar me ligj, të gjykatës së paanshme dhe asaj për të pasur një zgjidhje martese sipas ligjit bazohen në argumentet se Gjykata e Lartë: i. ka revokuar vendimin e saj për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, me vendimin e ndërmjetëm të datës 15.9.2022, vendim i cili është kundërshtuar nga kërkuari në datën 23.9.2022 dhe e ka shqyrtuar çështjen e kërkuarit në dhomë këshillimi në datën 6.10.2022, duke vendosur në përfundim mospranimin e rekursit të tij; ii. ka vendosur mospranimin e rekursit të tij, ndonëse kërkuari kishte parashtruar në rekurs pretendimin se gjykatat më të ulëta në kundërshtim të hapur me ligjin kishin legjitimuar paditësen për kërkimin e detyrimit ushqimor për vajzën madhore; iii. nuk ka riparuar shkeljet procedurale të gjykatave më të ulëta dhe ka kryer edhe vetë shkelje të mëtejshme, ndaj kërkuarit nuk i është respektuar e drejta kushtetuese për zgjidhjen e martesës sipas procedurave të parashikuara me ligj; iv. nuk ka vlerësuar rrethanat e konfliktit të interesit të gjyqtarës relatore në gjykatën e apelit dhe as rrethanën e caktimit të çështjes pa short tek ajo. Në këtë mënyrë, pretendimet e kërkuarit lidhen me të drejtën e procesit të rregullt ligjor të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e gjykatës së caktuar me ligj, së drejtës së aksesit të lidhur me të drejtën e mbrojtjes, si dhe së drejtës për të pasur një gjykim nga një gjykatë e paanshme. Duke mbajtur në konsideratë se neni 42 i Kushtetutës parashikon se të drejtat kushtetuese nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor, ndërsa neni 53 i saj garanton të drejtën kushtetuese për jetë familjare, ku përfshihet edhe garancia për zgjidhje të martesës sipas ligjit, nxirret përfundimi se pretendimet e kërkuarit hyjnë në juridiksionin e Gjykatës dhe ai legjitimohet *ratione materiae*.

38. Për sa u përket pretendimeve për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë dhe të standardit të arsyetimit të vendimit, referuar vendimit përfundimtar të asaj gjykate të datës 6.10.2022, Gjykata çmon se këto pretendime bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të shqyrtohen në vijim në lidhje me bazueshmërinë e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

39. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar për shkaqet me natyrë kushtetuese të rekursit dhe për argumentet e tjera të së njëjtës natyrë në parashtrimin me shkrim të paraqitur në datën 23.9.2022, përpara shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit. Ato kanë të bëjnë me evidentimin e të gjitha shkeljeve të të drejtave kushtetuese përgjatë gjykimin të çështjes në gjykatën e shkallës së parë dhe në gjykatën e apelit, në mënyrë të veçantë në drejtim të

³ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Marjana Semini.

kuptimit të përgjegjësisë prindërore dhe kufijve të ushtrimit të saj. Po kështu, ajo gjykata nuk ka dhënë përgjigje të arsyetuar as për shkeljen e së drejtës kushtetuese të evidentuar në vendimin e saj përfundimtar të datës 6.10.2022, lidhur me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit.

40. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka dhënë përgjigje të arsyetuar, si për sa u përket shkaqeve të vendimit të ndërmjetëm të datës 15.9.2022, përmes të cilit ka vendosur që çështjen ta shqyrtojë në dhomën e këshillimit dhe, me tej, pretendimit të kërkesit për revokimin e tij të shprehur në parashtrësën e datës 23.9.2022, ashtu edhe për sa i përket disponimit nga gjykatat e faktit për detyrimin e tij për të paguar për një pjesë të shpenzimeve për shkollimin e së bijës jashtë shtetit. Nga ana tjetër, pretendimet e kërkesit në rekurs dhe në parashtrësën me shkrim kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të vlerësimit të provave nga gjykatat e faktit dhe nuk janë të natyrës kushtetuese, për të cilat Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kanë respektuar normat procedurale të gjykimit, duke zhvilluar një proces të rregullt ligjor.

41. Gjykata ka theksuar se e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142/1 të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 42, datë 19.9.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

42. Duke iu referuar çështjes konkrete, Gjykata vëren se kërkesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë përmes të cilit ka kundërshtuar vendimin e gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar se nuk kanë respektuar dhe kanë zbatuar keq ligjin, pasi kanë shkelur rëndë procedurën për sa i përket disponimit në vendimet e tyre tej kërtimeve të padisë, formimit të ndërgjyqësisë, përcaktimit të detyrimit monetar në mënyrë arbitrare dhe dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm për atë detyrim, pa vlerësuar pagesat e kryera deri në datën e shpalljes së vendimit të gjykatës, nga të cilat i janë shkaktuar pasoja të rënda, pasi është detyruar që të paguajë dy herë për të njëjtin detyrim.

43. Lidhur me këtë rekurs, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka argumentuar se nuk përmban shkaqe ligjore të parashikuara në nenin 472 të KPC-së, të cilat ta bëjnë të cenueshëm vendimin e gjykatës së apelit (*shih paragrafin 15, të vendimit nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

44. Gjykata konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij ka paraqitur pretendimet kryesore të parashtruara në rekurs që kanë të bëjnë me thelbin e mosmarrëveshjes, dhe ai vendim përmban palët ndërgjyqëse, bazën ligjore, vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta, faktin se kërkesi ka paraqitur rekurs, si dhe parashtrimin me shkrim pas vendimit të datës 15.9.2022. Ndërsa në aspektin përmbajtësor, ai u ka dhënë përgjigje shkaqeve në rekurs për sa i takon zbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e faktit, të cilat, në thelb, lidheshin me detyrimin për të paguar shpenzimet e shkollimit jashtë shtetit të së bijës së kërkesit. Ai kolegji, pas shqyrtimit të shkaqeve të rekursit dhe interpretimit të parashikimeve ligjore të zbatueshme për rastin në shqyrtim, ka arsyetuar se është i pabazuar pretendimi se gjykatat e faktit kanë dalë tej disponimit të palëve dhe se mbështetur në nenet 197, 215 dhe 216 të Kodit të Familjes, detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmija madhor ndjek shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën 25 vjeç (*shih paragrafët 22 dhe 23, të vendimit nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

45. Gjykata çmon se vendimi përfundimtar i datës 6.10.2022, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë nivel të pamjaftueshëm arsyetimi, pasi nuk konstatohen mangësi në drejtim të faktit që pretendimet e kërkuarit nuk janë vlerësuar përmes shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, përkundrazi, ai kolegji u ka dhënë përgjigje të arsyetuar shkaqeve të rekursit, duke shprehur qëndrimin e tij për to. Referuar pretendimit të kërkuarit se përmes vendimit nuk ka marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs, fakti që ai kolegji në pjesën hyrëse të vendimit nuk i ka listuar të gjitha shkaqet e tjera të rekursit, veçanërisht pretendimin për dhënien e vendimit nga gjykata e apelit në kushtet e njëanshmërisë, nuk nënkupton se nuk është vënë në lëvizje për ekzaminimin e rekursit në tërësi apo se nuk ka mbajtur qëndrim mbi to. Përmes vendimit që kundërshtohet, kërkuari ka marrë përgjigje të arsyetuar për shkaqet rekursit, ndër të tjera edhe në lidhje me pretendimin për dhënien e vendimit nga gjykata e apelit në kushtet e njëanshmërisë. Për sa kohë Gjykata e Lartë ka vlerësuar se nuk rezulton të ketë shkaqe të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit nga gjykata e apelit dhe se pretendimet dhe shkaqet e tjera të ngritura në rekurs përbëjnë çështje të vlerësimit të provës, çka del jashtë juridiksionit rishikues të saj, mbi këtë arsye kërkuari ka marrë përgjigje edhe për atë pretendim *(shih paragrafin 21, të vendimit nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë)*.

46. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë në kontekst të pretendimeve të kërkuarit për sa u përket parregullsive të procesit gjyqësor në gjykatat më të ulëta, si dhe në kontekst të funksionit të saj si gjykatë ligji, nuk cenon standardin e arsyetimit në kuptimin kushtetues dhe as në tërësi elementet e një gjykimi të drejtë, për rrjedhojë ky pretendim është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

47. Kërkuari ka pretenduar se Gjykata e Lartë, ndonëse ka pasur në dispozicion numrin e plotë të gjyqtarëve, për çështjen civile të regjistruar në datën 8.5.2015, ka disponuar me vendim në datën 6.10.2022, duke tejkaluar edhe afatin ligjor të zgjatur pas ndryshimeve të KPC-së, edhe pse për atë çështje ka pasur disa kërkesa për gjykimin me procedurë të përsheptuar. Po kështu, i gabuar është edhe vendimi i asaj gjykate nr. 4, datë 22.5.2018, përmes të cilit ka rrëzuar kërkesën e datës 21.2.2018, me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të gjykimit nga Kolegji Civil. Mosshqyrtimi i çështjes brenda një afati të arsyeshëm ka sjellë pasoja ekonomike në dëm të kërkuarit.

48. Subjektet e interesuara kanë prapësuar se ky pretendim është i pabazuar, pasi, ndonëse kërkuari ka paraqitur disa kërkesa për shqyrtimin e çështjes me procedurë të përsheptuar, në kushtet kur themeli i mosmarrëveshjes është zgjidhur me vendim përfundimtar, ai nuk mund të realizojë rivendosjen e kësaj të drejte përmes gjykimit kushtetues.

49. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo, për mbrojtjen e së drejtës së pronës ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm.

50. Gjykata ka theksuar se standardi për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm bazohet në katër kritere: i. sjelljen e kërkuarit; ii. kompleksitetin e çështjes; iii. sjelljen e autoriteteve; iv. rëndësinë e asaj çfarë rrezikon kërkuari *(shih vendimet nr. 46, datë 3.10.2023; nr. 6, datë 16.2.2023; nr. 13, datë 26.5.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

51. Për sa i përket vlerësimit të pretendimit të kërkuarit, në përfundim të diskutimeve, në zbatim të nenit 72, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimmarrje, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000.

52. Sipas njërit qëndrim⁴, referuar standardeve kushtetuese dhe konventore që lidhen me të drejtën për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm, kohëzgjatja më shumë se 7 vjet e shqyrtimit të rekursit të kërkesit nga Gjykata e Lartë nuk justifikohet dhe bie ndesh me nenin 42 të Kushtetutës për katër arsye: i. sjellja e kërkesit nuk rezulton të jetë bërë shkak për vonesën; ii. çështja gjyqësore në tërësinë e saj nuk ka qenë komplekse, madje ka përfunduar në Gjykatën e Lartë me vendim për mospranimin e rekursit; iii. sjellja e autoriteteve është bërë shkak kryesor për kohëzgjatjen e paarsyeshme, duke mbajtur në konsideratë, midis të tjerave, edhe faktin se rekursi i kërkesit është regjistruar në vitin 2015, kur efektet e reformës në drejtësi ende nuk kishin filluar; iv. çështja gjyqësore e kërkesit lidhej në themel me zgjidhjen e martesës dhe rregullimin e pasojave të saj, përfshirë detyrimet ushqimore për fëmijët, që përbën interes të rëndësishëm që duhet garantuar nga autoritetet publike, përfshirë gjykatat.

53. Sipas qëndrimit tjetër⁵, kërkesa duhet rrëzuar, pasi, në thelb, pretendimet kanë të bëjnë me interesa pasurorë të kërkesit, që, sipas tij, janë cenuar për shkak të disponimit për to me vendim gjyqësor me ekzekutim të përkohshëm, për të cilat KPC-ja ka parashikuar edhe mjete të tjera efektive për t'i mbrojtur. Për më tepër, siç rezultoi gjatë gjyqimit, pas vendimit të datës 22.5.2018, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për rrëzimin e kërkesës së datës 21.2.2018, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave të gjyqimit, kërkesi ka paraqitur kërkesë për shqyrtimin e rekursit të tij me procedurë të përsheptuar në datën 24.11.2020, e cila është pranuar nga gjyqtari relator në vitin 2022, përpara shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, interesi i kërkesit nuk është rrezikuar në shkallë të konsiderueshme nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore.

54. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkesit për vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, konkretisht për cenimin e standardit të arsyetimit, është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, kurse për pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm nuk u arrit numri i kërkuar i votave për vendimarrje, sipas nenit 133, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 133, pika 2, të Kushtetutës, si dhe neneve 71, 72 dhe 73, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 18.10.2023.

Shpallur më 24.11.2023.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari (pjesërisht kundër)

Anëtarë: Elsa Toska, Genti Ibrahimi, Sonila Bejtja

⁴ Votuan sipas këtij qëndrimi gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Marjana Semini.

⁵ Votoi sipas këtij qëndrimi gjyqtari Genti Ibrahimi.

Anëtarë (pjesërisht kundër): Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Marjana Semini

MENDIM PARALEL

1. Për çështjen me kërkues Mitat Dautaj, me objekt “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 3998, datë 2.12.2014, të Gjykatës së Apelit, nr. 21001-01221-00-2015 regjistri themeltar, datë 15.9.2022 dhe nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, pavarësisht se pajtohemi me shumicën për rrëzimin e kërkesës për themelin, nuk ndajmë të njëjtin qëndrim për përfundimin e arritur në lidhje me dy kritere të legjitimitit, përkatësisht *shterimin e mjeteve juridike efektive* dhe legjitimitimin *ratione temporis* të kërkuesit për pretendimin për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga Gjykata e Lartë, ndaj çmojmë të shprehemi, për sa vijon.

2. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesi ka plotësuar kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000. Sipas saj, kërkesa për përshpejtimin e procedurave në rastin e kërkuesit e ka humbur qëllimin e saj - përshpejtimin e procedurave ose parandalimin e tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë. Pra, mjeti juridik “kërkesa për përshpejtimin e procedurave”, që kërkuesi ka pasur në dispozicion sipas dispozitave të KPC-së, në rastin e saj nuk ka qenë *efektiv*, në kuptimin që nuk ka qenë real, i drejtpërdrejtë, konkret dhe i shpejtë në kohë. Në këtë kuptim, i vetmi mjet në dispozicion të kërkuesit për rivendosjen e së drejtës së cenuar është ankimi kushtetues individual, për rrjedhojë në çështjen konkrete përmbushet kriteri i shterimit të mjeteve juridike (*shih paragrafin 30 të vendimit*). Shumica e ka legjitimuar kërkuesin edhe *ratione temporis*, pasi, sipas saj, në lidhje me kërkimin për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, shkelja ka qenë vazhduese deri në datën 6.10.2022, kur Gjykata e Lartë ka disponuar me vendim përfundimtar për çështjen e tij (*shih paragrafin 33, të vendimit*). Për rrjedhojë, në vijim, ajo e ka analizuar këtë pretendim sipas kriterëve të zhvilluara nga jurisprudenca kushtetuese për vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit.

3. Nga përmbajtja e ankimit kushtetues individual konstatojmë se kërkuesi pretendimin e tij për cenimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit e ka lidhur me dy rrethana: i. me tejzgjatjen e procesit të themelit në Gjykatën e Lartë; ii. me vendimin nr. 4, datë 22.5.2018, të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. (*shih paragrafin 16.5 të vendimit*).

4. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se “ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, por ajo mund ta ushtrojë këtë kompetencë, duke analizuar faktet e natyrës kushtetuese” (*shih vendimin nr. 18, datë 31.3.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtejshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 29, datë 30.3.2017; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

5. Në praktikën e Gjykatës, pas hyrjes në fuqi të dispozitave të reja procedurale të KPC-së në vitin 2017, është konsideruar se kërkuesit kanë mjete juridike në dispozicion dhe nuk kanë nevojë të presin përfundimin e procesit të themelit për të kërkuar mbrojtjen juridike të kësaj të drejte, përfshirë edhe mbrojtjen kushtetuese (*shih vendimet nr. 35, datë 1.11.2021; nr. 34, datë 1.11.2021; nr. 33, datë 1.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Në drejtim të së drejtës për kohëzgjatje të arsyeshme, sipas nenit 42 të Kushtetutës, legjislacioni procedural ka parashikuar mjete të reja juridike, të cilat përbëjnë në parim mjete efektive në dispozicion të individëve për të kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës në drejtim të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit, si dhe përshpejtimin e tij dhe riparimin e shkeljes, por, gjithsesi, ato nuk kanë përjashtuar kontrollin kushtetues të kësaj Gjykata, i cili vihet në lëvizje pasi kërkuarit kanë provuar se kanë shteruar në formë dhe substancë këto mjete ose kur ato kanë rezultuar joefektive për shkak të dështimit të organit kompetent, sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së, për të marrë në shqyrtim kërkesën brenda një afati të arsyeshëm.

7. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, ndërkohë që rekursi ishte në pritje për t'u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë, rezultoi se kërkuari i është drejtuar me kërkesë zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë në datën 24.11.2020, me objekt gjykimin me procedurë të përshpejtuar të çështjes nr. 21001-01221-00-2015, sikundër kishte vepruar edhe më parë me kërkesat e të njëjtit lloj të paraqitura prej tij në datat 6.7.2015, 27.5.2016, 14.11.2016, 30.1.2017, 26.4.2017, 10.11.2017 dhe 14.11.2017, duke pretenduar se çështja ka të bëjë me pasojat e zgjidhjes së martesës dhe, për këtë shkak, hyn në rrethin e çështjeve civile që Gjykata e Lartë shqyrtonte me procedurë të përshpejtuar.

8. Për sa më lart, kërkesa që i është drejtuar zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë në datën 24.11.2020, në vlerësimin tonë nuk mund të konsiderohet e paraqitur në formën e kërkuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjyimit nga Gjykata e Lartë, pasi nuk i është drejtuar organit kompetent (neni 399/6, shkronja “c”), dhe në këtë kuptim nuk përbën mjet procedural të ushtruar sipas kërkesave ligjore. Në këtë kontekst, mosparaqitja e një kërkesë sipas parashikimeve ligjore procedurale, përbën fakt të natyrës kushtetuese që nuk mund të kapërcehet, ndaj mungesa e saj duhet të sillte moslegjitimitimin e kërkuarit për mosshkrim të mjetit juridik, edhe në kushtet e një shkeljeje vazhduese, në të kundërt të sa ka argumentuar shumica për këtë element (*shih paragrafin 30 të vendimit*). Po në këtë kontekst, shumica do të duhej të bënte dallimin mes “kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjyimit”, e parashikuar nga nenet 399/1 e në vijim të KPC, që synon konstatimin e shkeljes, përshpejtimin por më pas edhe shpërblimin e drejtë, nga “kërkesa me shkrim drejtuar relatorit” bazuar në nenin 482/4 të KPC-së, si dhe në kreun II, pika 4 të vendimit nr. 78, datë 30.5.2019, “Për kalendarin e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatën e Apelit” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që si mjet procedural i referohet dhe synon vetëm përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, sipas vlerësimit të relatorit.

9. Gjithsesi, theksojmë se pavarësisht sa më lart, Gjykata e Lartë (relatori) e ka marrë në konsideratë kërkesën, duke e shqyrtuar përfundimisht çështjen e themelit, fakt që rezultoi edhe nga vendimi nr. 2821/2022 i kësaj gjykate (*shih paragrafin 14, të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për më tepër, edhe duke iu referuar pretendimeve të kërkuarit lidhur me vendimin nr. 4, datë 22.5.2018, të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur rrëzimi i kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit.

10. GJEDNJ-ja ka vlerësuar se kur shkelja e pretenduar përbën një situatë të vazhdueshme kundër së cilës nuk ka mjete juridike të brendshme, periudha 6-mujore fillon të rrjedhë vetëm kur kjo situatë përfundon (*shih Sabri Güneş kundër Turqisë [GC], nr. 27396/06, § 54, datë 29.6.2012*). Për sa kohë që situata vazhdon ky rregull nuk është i zbatueshëm (*shih Iordache kundër Rumanisë, § 50; Oliari dhe të tjerët kundër Italisë, §§ 96–97*). Megjithatë, një situatë e vazhdueshme nuk mund të shtyjë për një kohë të pacaktuar zbatimin e afatit të paraqitjes së kërkesës. GJEDNJ-ja ka përcaktuar detyrimin për të treguar kujdesin e duhur dhe iniciativën për aplikantët që dëshirojnë të ankohen për dështimin e vazhdueshëm të shtetit për të përmbushur disa prej detyrimeve të tij (*shih Varnava etj. kundër Turqisë*

[GC], §§ 159–172; *Sargsyan kundër Azerbajxhanit (dek.)* [GC], §§ 124–148; *Sokolov etj. kundër Serbisë (dek.)*, §§ 31–36).

11. Në kushtet kur edhe pse jemi para një shkelje vazhduese, kërkuesi nuk ka paraqitur kërkesa në kuptim të mjeteve të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, në formën e kërkuar sipas këtyre dispozitave, pavarësisht nëse do të kishte apo jo një vendimmarrje në lidhje me to nga Gjykata e Lartë për periudhën e tejzgjatjes pas vendimit nr. 4/2018, si dhe kur situata e vazhdueshme nuk mund të shtyjë për një kohë të pacaktuar zbatimin e këtij rregulli, vlerësojmë se kërkuesi nuk ka përmbushur detyrimin për të treguar kujdesin e nevojshëm dhe iniciativën për t'u ankuar në kohën e duhur në këtë Gjykatë për dështimin e vazhdueshëm të Gjykatës së Lartë për shqyrtimin e çështjes brenda afateve të arsyeshme.

12. Për të gjitha sa më lart, në vlerësimin tonë kërkuesi nuk ka qenë në rrethana të tilla që të shkarkohej nga detyrimi për të shteruar *mjetet juridike efektive* në dispozicion për periudhën pas dhënies së vendimit nr. 4/2018, për sa kohë që shkelja është konsideruar vazhduese prej tij. Po ashtu, sikundër theksuam edhe më sipër, për sa i përket vendimit nr. 4, datë 22.5.2018, të Gjykatës së Lartë, çmojmë se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*. Për rrjedhojë, referuar nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 8577/2000, shumica nuk duhet të vijonte me analizën në themel të pretendimit për kohëzgjatje të paarsyeshme të procesit, sipas standardeve të kërkuara nga nenin 42 i Kushtetutës dhe jurisprudenca kushtetuese.

Anëtare: Elsa Toska. Sonila Bejtja

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Mitat Dautaj me objekt: “*Shfuqizimi i vendimeve nr. 3717, datë 9.4.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 3898, datë 2.12.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 21001-01221-00-2015 të regjistrit themeltar, datë 15.9.2022 dhe nr. 00-2022-2821, datë 6.10.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajftueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, jemi kundër qëndrimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar për kërkimin që lidhej me shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë kundër.

2. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesi ka qenë palë në një proces gjyqësor për zgjidhjen e martesës, në përfundim të të cilit është vendosur pranimi i padisë së subjektit të interesuar (bashkëshortes), caktimin tek ajo për rritje dhe edukim të djalit të tyre të mitur dhe detyrimin e kërkuesit që t'i paguajë paditëses kontribut financiar për rritjen dhe edukimin e tij në shumën 20.000 lekë në muaj, si dhe kontribut financiar në shumën 70.000 lekë në muaj për edukimin e vajzës, e cila në atë moment ishte nën moshën 25 vjeç dhe ndiqte studimet universitare. Kërkuesi ka paraqitur ankim për detyrimin e caktuar nga gjykata për vajzën, për të cilin, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në datën 31.12.2014, kërkuesi ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, ndërsa në vijim në datën 21.2.2018, ai i është drejtuar kësaj gjykate me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshejtimin e procedurave të shqyrtimit të rekursit. Gjykata e Lartë, me vendimin e datës 22.5.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Ndërsa me vendimin e datës 15.9.2022, kjo gjykatë ka vendosur revokimin e

vendimit për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore dhe kalimin e saj për shqyrtim në dhomën e këshillimit. Më tej, Gjykata e Lartë, në datën 6.10.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit.

3. Në vijim, kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual duke kundërshtuar vendimarrjen e Gjykatës së Lartë: i. për vendimin e revokimit të kalimit të çështjes në seancë, pasi i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, në aspekt të së drejtës së aksesit, për t'u dëgjuar dhe gjykatës së caktuar me ligj; ii. dhe për procesin e themelit, pasi i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, në aspekt të së drejtës së aksesit, së drejtës për një gjykatë të paanshme, parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit, së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, standardit të arsyetimit të vendimit, së drejtës për të pasur një zgjidhje martese sipas ligjit dhe së drejtës për ndreqjen apo fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota, ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin.

4. Shumica, në analizë të përmbushjes së kriterëve të pranueshmërisë së pretendimeve të kërkuarit, ka vlerësuar se, për sa i përket cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe të kontradiktoritetit dhe së drejtës për ndreqjen apo fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota, ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin, ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "F", të Kushtetutës.

5. Lidhur me pretendimet për cenimin e së drejtës së aksesit, për t'u dëgjuar dhe gjykatës së caktuar me ligj, referuar vendimit të revokimit të kalimit të çështjes në seancën e datës 15.9.2022, të Gjykatës së Lartë, si dhe të drejtave të aksesit në gjykatë, për një gjykatë të paanshme dhe për të pasur një zgjidhje martese sipas ligjit, referuar vendimit përfundimtar, datë 6.10.2022, të Gjykatës së Lartë, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimarrje për legjitimitimin *ratione materiae*, sipas parashikimeve të nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, të detajuar edhe në nenin 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000. Lidhur me këto pretendime, qëndrimi ynë gjen pasqyrim në paragrafin 37 të vendimit. Ndërsa, për pretendimet e tij në drejtim të cenimit të së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm dhe standardit të arsyetimit të vendimit, shumica ka arritur në përfundimin se kërkuesi e ka përmbushur kriterin e legjitimitimit *ratione materiae*. Edhe për sa i përket së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, megjithëse u konsiderua i përmbushur kriteri i legjitimitimit *ratione materiae*, Gjykata nuk arriti numrin e kërkuar të votave për vendimarrje, për të cilin qëndrimi ynë gjen pasqyrim në paragrafin 52 të vendimit.

6. Për sa i takon pretendimit të kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit, shumica e ka konsideruar të pabazuar, pasi ka vlerësuar se vendimi i Gjykatës së Lartë u ka dhënë përgjigje shkaqeve në rekurs, për sa i takon zbatimit të drejtë të ligjit material dhe procedural nga gjykatat e faktit, të cilat, në thelb, lidheshin me detyrimin për të paguar shpenzimet e shkollimit jashtë shtetit të së bijës së kërkuarit. Ai kolegji, pas ekzaminimit të shkaqeve në rekurs dhe interpretimit të parashikimeve ligjore të zbatueshme për rastin në shqyrtim, ka arsyetuar se është i pabazuar pretendimi se gjykatat e faktit kanë dalë tej disponimit të palëve dhe se mbështetur në nenet 197, 215 dhe 216 të Kodit të Familjes, detyrimi për ushqim vazhdon edhe për kohën që fëmija madhor ndjek shkollën e mesme ose të lartë, deri në moshën 25 vjeç. Gjithashtu, sipas shumicës, vendimi i Gjykatës së Lartë nuk rezulton të ketë nivel të pamjaftueshëm arsyetimi, pasi nuk konstatohen mangësi në drejtim të faktit që pretendimet e kërkuarit nuk janë vlerësuar përmes shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, përkundrazi, ai kolegji u ka dhënë përgjigje të arsyetuar shkaqeve të rekursit, duke shprehur qëndrimin e tij për to. Referuar pretendimit se përmes vendimit nuk ka marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs, fakti që ai kolegji në pjesën hyrëse të vendimit nuk i ka listuar të gjitha shkaqet e tjera të rekursit, veçanërisht pretendimin për dhënien e vendimit nga gjykata e apelit në kushtet e njëanshmërisë, nuk nënkupton se nuk është vënë në lëvizje për ekzaminimin e rekursit në tërësi apo që nuk ka mbajtur

qëndrim për to. Përmes vendimit që kundërshtohet, kërkuesi ka marrë përgjigje të arsyetuar për shkaqet rekursit, ndër të tjera, edhe në lidhje me pretendimin për dhënien e vendimit nga gjykata e apelit në kushtet e njëanshmërisë. Për sa kohë Gjkata e Lartë ka vlerësuar se nuk rezulton të ketë shkaqe të rënda procedurale, të cilat të kenë ndikuar dukshëm në dhënien e vendimit nga gjykata e apelit dhe se pretendimet dhe shkaqet e tjera të ngritura në rekurs përbëjnë çështje të vlerësimit të provës, çka del jashtë juridiksionit rishikues të saj, mbi këtë arsyetim kërkuesi ka marrë përgjigje edhe për atë pretendim (*shih paragrafët 44–45 të vendimit*).

7. Nuk pajtohem me këtë vlerësim të shumicës, pasi çmojmë se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar kërkuesit standardin e arsytimit të vendimit, i cili duhej të ishte analizuar i lidhur me të drejtën për të pasur një zgjidhje martese sipas ligjit, në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës dhe me të drejtën për ndreqjen apo fshirjen e të dhënave të pavërteta apo të paplota, ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin, në kuptim të nenit 35 të Kushtetutës.

8. Ashtu siç ka pohuar shumica, e drejta për proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga neni 42 i Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, i cili përkon edhe me detyrimin e gjykatave për të arsyetuar vendimet, sipas nenit 142/1 të Kushtetutës. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 42, datë 19.9.2023; nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në rastin konkret, konstatohet se në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, kërkuesi ka pretenduar se gjykatat e faktit kanë zbatuar keq ligjin, pasi kanë shkelur rëndë procedurën, për sa i përket disponimit në vendimet e tyre tej kërkimeve të padisë, formimit të ndërgjyqësisë, përcaktimit të detyrimit monetar në mënyrë arbitrare dhe dhënies së vendimit me ekzekutim të përkohshëm për atë detyrim, pa vlerësuar pagesat e kryera deri në datën e shpalljes së vendimit të gjykatës, nga të cilat i janë shkaktuar pasoja të rënda, pasi është detyruar që të paguajë dy herë për të njëjtin detyrim.

10. Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj e ka gjetur të pabazuar shkakun e ngritur në rekurs se gjykata e faktit ka dalë tej disponimit të palëve, si dhe shkakun e keqinterpretimit të ligjit material, duke arritur në përfundimin se pretendimet e shkaqet e tjera të ngritura në rekurs përbëjnë çështje të vlerësimit të provave, çka del jashtë juridiksionit rishikues të Gjykatës së Lartë.

11. Ne, gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë se vendimi i Gjykatës së Lartë ka mangësi në drejtim të faktit se kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet me natyrë kushtetuese të parashtruara në rekurs, duke krijuar, nga njëra anë, dyshimin nëse ai realisht është dëgjuar lidhur me atë çfarë ka kërkuar dhe, nga ana tjetër, pamundësinë e tij për të kundërshtuar rezultatin e çështjes. Pretendimi në rekurs për formimin e ndërgjyqësisë *prima facie* ka të bëjë me zbatimin e keq të ligjit procedural, pasi lidhet me vendimmarrjen e gjykatave më të ulëta për pranimin e kërimit të bashkëshortes për detyrimin për ushqim edhe për vajzën madhore të moshës 25 vjeç. Kjo e fundit në këtë moshë ka zotësi të plotë për të vepruar dhe, si e tillë, mbart të drejtën për të paraqitur në emër dhe për llogari të saj kërkime në gjykatë. Për këtë pretendim, Gjykata e Lartë, në mënyrë të paqartë, ka arsyetuar se rekursi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje pretendimit të kërkuesit për të drejtën e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, e cila jo vetëm nuk e ka listuar në shkaqet e rekursit, por nuk i ka dhënë as përgjigje, qoftë edhe me arsyetim të kufizuar. Me fjalë të tjera, arsyetimi i pamjaftueshëm dhe i paqartë i

vendimit të Gjykatës së Lartë nuk duket t'i ketë shërbyer funksionit kryesor, atij që e bën vendimin gjyqësor të drejtë, por i ka cenuar kërkuesit edhe të drejtën për të pasur një zgjidhje martese sipas ligjit, në kuptim të nenit 53 të Kushtetutës dhe të drejtën për ndreqjen apo fshirjen e të dhënave të pavërteta ose të paplota, ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin, në kuptim të nenit 35 të Kushtetutës.

12. Në përfundim, ne, gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë se ankimi kushtetues individual i kërkuesit duhej të pranohej pjesërisht dhe të vendosej shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari

Anëtare: Fiona Papajorgji